



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI I BASHKISË

VENDIM

Nr. 20, datë 23.04.2020

PËR  
CAKTIMIN E NJË PREJ ZËVËNDËSKRYETARËVE TË BASHKISË DURRËS,  
PËR KRYERJEN E FUNKSIONEVE TË KRYETARIT TË BASHKISË, DERI NË  
ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË RI, PËR SHKAK TË DORËHEQJES NGA  
FUNKSIONET DHE DETYRA TË Z. ZHULJEN VARFAJ

Në mbështetje të nenit 113, pika 1 dhe 2, të Pjesës së Gjashtë “Qeverisja Vendore” e ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” e ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nenpika 1.1, gërma “b”, neni 55, pika 6, neni 61, pika 1, gërma “b”, pika 5, të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, të Rregullores së Këshillit Bashkiak, në mbledhjen emergjente të datës 23.04.2020, Këshilli Bashkiak Durrës,

V E N D O S I :

1. Caktimin e znj.**Emiriana Sako** për kryerjen e funksioneve të Kryetares së Bashkisë, deri në zgjedhjen e Kryetarit të ri, për shkak të dorëheqjes nga funksionet e Kryetarit të Bashkisë dhe detyra të z. Zhuljen Varfaj.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Bashkia Durrës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK  
ANI DYRMISHI



U shpall sot me datë 23.04.2020